



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

Kuvendi i Komunës

Nr. 002/31

Datë: 30.04.2026

Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji Nr.03/L-40, GZRK numër 28/2008), nenit 21 paragrafi 21.1 pika h) të Statutit të Komunës së Junikut dhe nenit 7 paragrafi 5 të rregullores së punës së Kuvendit të Komunës së Junikut, Kuvendi i Komunës së Junikut në mbledhjen e tij të rregullt të mbajtur më 30.04.2026 nxjerrë:

V E N D I M

për miratimin e Planit të punës së Kuvendit të Komunës së Junikut për vitin 2026 dhe orari i mbajtjes së takimeve

- I. Me këtë vendim miratohet Plani i punës së Kuvendit të Komunës së Junikut për vitin 2026 dhe orari i mbajtjes së takimeve / në tekstin e mëtejshëm Plani/.
- II. Plani është dokument public dhe do të publikohet në ueb faqen zyrtare të Komunës së Junikut.
- III. Kuvendi i Komunës së Junikut është i obliguar që ta respektojë dhe zbatojë Planin gjatë vitit 2026.
- IV. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është plani i miratuar nga pika I, e këtij vendimi.
- V. Ky vendim lyp në fuqi 30 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhët zyrtare në uebfaqen zyrtare të Komunës së Junikut.

Me këtë vendim njoftohen:

1. MAPL,
2. Kryetari i Komunës së Junikut,
3. Shërbimi i Kuvendit të Komunës,
4. Arkivi i Komunës së Junikut.

Kryesuesi i Kuvendit
z. Leonard Lollaj.





REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA- REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK-OPSTINA JUNIK-MUNICIPALITY JUNIK



Numër : 002/31
Data : 30.04.2026

PLANI I PUNËS SË KUVENDIT KOMUNAL TË JUNIKUT PËR VITIN 2026

Hyrje:

Kuvendi i Komunës është organi më i lartë në komunë dhe zgjidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga qytetarët në pajtim me Ligjin mbi Zgjedhjet Lokale (neni 35 paragrafi 35.1 i LVL-së).

Kuvendi i Komunës së Junikut ka për obligim të zbatojë rolin e tij legjislativ dhe drejtues në përputhje me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale dhe ligjet e tjera të Republikës së Kosovës.

Plani i punës së Kuvendit të Komunës së Junikut për vitin 2026 është dokument orientues i aktiviteteve të Kuvendit të Komunës së Junikut për vitin 2026, duke paraqitur veprime konkrete të planifikuara, me qëllim të përmbushjes së detyrave të tij në fushën e legjislacionit dhe të mbikëqyrjes si dhe të ngritë transparencën dhe llogaridhënien para qytetarëve Junikas.

Ky plan mund të pësoj ndryshime varësisht prej nevojave që paraqiten me kalimin e kohës.

Objektivat

- Si organi më i lartë, Kuvendi i Komunës së Junikut ka për objektiv krijimin e kornizës ligjore që definon parametrat brenda së cilës:
 - 1) I do të funksionojë administrata (ekzekutivi),
 - 2) do të mbikëqyrë dhe monitorojë aktivitetet e administratës (ekzekutivit) për t'u siguruar se ato janë në përputhje me kornizën ligjore,
 - 3) në bashkëpunim me administratën (ekzekutivin), të vendosë drejtimin strategjik për zhvillimin ekonomik, fizik dhe financiar të Komunës së Junikut, dhe
 - 4) siguron që parimet e një shoqërie demokratike janë të qëndrueshme në mënyrën me të cilën realizon rolin e tij legjislativ dhe drejtues.

Qëllimi

- Plani vjetor i punës së Kuvendit të Komunës së Junikut shërben si mjet për të arritur qëllimet e mëposhtme përmes planifikimit të plotë dhe të kujdesshëm.
-

Plani i punës së Kuvendit të Komunës së Junikut për vitin 2026:

1. Siguron që Kuvendi i Komunës së Junikut po i përmbush obligimet ligjore duke i miratuar të gjitha rregulloret që i parasheh ligji dhe që janë të nevojshme për shfrytëzim efektiv të resurseve të Komunës së Junikut,
2. Shërben si një instrument me anë të të cilit Kuvendi i Komunës së Junikut mund të mbikëqyrë punën e administratës (ekzekutivit) përmes dorëzimit të raporteve financiare dhe të performancës,
3. Funkcionon si mjet që shton gjasat për arritjen e objektivave të Komunës së Junikut përmes ndërtimit të një kornize ligjore të qëndrueshme,
4. Ngrit efikasitetin e punës së Kuvendit të Komunës së Junikut dhe të administratës (ekzekutivit) në përgjithësi, dhe
5. Ngrit transparencën e Kuvendit të Komunës së Junikut. (Qytetarët janë të informuar për aktivitetet e planifikuara paraprakisht dhe kështu mund të jenë më të frytshëm në punën e Kuvendit të Komunës së Junikut, në veçanti duke dhënë kontribut në vendimet që kanë rrjedhoja afatgjata dhe të rëndësishme financiare, ekonomike dhe sociale në Komunën e Junikut.)

<i><u>Muaj</u></i>	<i><u>Aktivitetet e Kuvendit</u></i>	<i><u>Data</u></i>	<i><u>Aktivitetet e Komitetit për Politikë dhe Financa</u></i>	<i><u>Data</u></i>	<i><u>Aktivitetet e Komitetit për Komunitet e</u></i>	<i><u>Data</u></i>
Janar	1.Shqyrtimi i Raportit financiar për tremujorin e katërt, tetor-dhjetor 2025; 2.Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të punës i komitetit për Komunitete për vitin 2026.	02.02.2026	1.Shqyrtimi i Raportit financiar për tremujorin e katërt, tetor-dhjetor 2026; 2.Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të punës i komitetit për Komunitete për vitin 2026.			

	3.Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të punës i komitetit konsultativ për persona me aftësi të kufizuara për vitin 2026; 4.Shqyrtimi i Raportit të punës së Kuvendit Komunal për vitin 2025; 5.Shqyrtimi i Raportit të punës së Kryetarit për vitin 2025; 6.Raporti i punës së KKS-së për vitin 2025; 7.Shqyrtimi i Raportit të punës së prokurimit për vitin 2025;		3.Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të punës i komitetit konsultativ për persona me aftësi të kufizuara për vitin 2026; 4.Shqyrtimi i Raportit të punës së Kuvendit Komunal për vitin 2026; 5.Shqyrtimi i Raportit të punës së Kryetarit për vitin 2025; 6.Raporti i punës së KKS-së për vitin 2025; 7.Shqyrtimi i Raportit të punës së prokurimit për vitin 2025;			
Shkurt	Seancë solemne me rastin e ditës së pavarësisë së Republikës së Kosovës (17 shkurt); 1.Shqyrtimi dhe miratimi i inicimit të procedurave për hartimin e Planit Lokal për Veprim në Mjedis; 2. Shqyrtimi dhe miratimi i inicimit të procedurave për hartimin e Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal 2026-2033;	17.02.2026 27.02.2026	1.Shqyrtimi dhe miratimi i inicimit të procedurave për hartimin e Planit Lokal për Veprim në Mjedis; 2. Shqyrtimi dhe miratimi i inicimit të procedurave për hartimin e Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal 2026-2033;	18.02.2026		

	3.Shqyrtimi dhe miratimi i inicimit të procedurave për hartimin e Planeve Strategjike të Komunës së Junikut, të cilat janë në kompetencë të Drejtorisë DSHPIMSH: Plani i vlerësimit të rrezikut; Plani për reagim emergjent; Plani i transportit publik dhe i mobilitetit; Plani për mirëmbajtjen e rrugëve dhe hapësirave publike; Plani për mirëmbajtjen e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit; Plani komunal për menaxhimin e mbeturinave; dhe Plani komunal për menaxhimin dhe kontrollin e qenve me dhe pa pronar. 4.Themelimi i komisionit të Kuvendit të Komunës për zgjedhjen e Këshillave Lokal dhe komisioni i ankesave lidhur me procesin e zgjedhjeve të Këshillave Lokal. 5.Shqyrtimi dhe miratimi i inicimit të procedurës për hartimin e Planit zhvillimor të Arsimit në Komunën e Junikut 2026-2030;		3.Shqyrtimi dhe miratimi i inicimit të procedurave për hartimin e Planeve Strategjike të Komunës së Junikut, të cilat janë në kompetencë të Drejtorisë DSHPIMSH: Plani i vlerësimit të rrezikut; Plani për reagim emergjent; Plani i transportit publik dhe i mobilitetit; Plani për mirëmbajtjen e rrugëve dhe hapësirave publike; Plani për mirëmbajtjen e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit; Plani komunal për menaxhimin e mbeturinave; dhe Plani komunal për menaxhimin dhe kontrollin e qenve me dhe pa pronar. 4.Themelimi i komisionit të Kuvendit të Komunës për zgjedhjen e Këshillave Lokal dhe komisioni i ankesave lidhur me procesin e zgjedhjeve të Këshillave Lokal. 5.Shqyrtimi dhe miratimi i inicimit të procedurës për hartimin e Planit zhvillimor të Arsimit në Komunën e Junikut 2026-2030;			
--	---	--	---	--	--	--

Mars	1.Shqyrtimi i kërkesës për bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2025 në vitin 2026; 2.Njoftim mbi shfrytëzimin e pronave Komunale; 3.Shqyrtimi dhe miratimi i inicimit të procedurave për hartimin e planit tre vjeçar për banim social. 4.Themelimi i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) 5.Shqyrtimi dhe miratimi i inicimit të procedurës për hartimin e “Planit për menaxhimin e Tokave Rurale 2026-2030”	31.03.2026	1.Shqyrtimi i kërkesës për bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2025 në vitin 2026; 2.Njoftim mbi shfrytëzimin e pronave Komunale; 3.Shqyrtimi dhe miratimi i inicimit të procedurave për hartimin e planit tre vjeçar për banim social. 4.Themelimi i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) 5.Shqyrtimi dhe miratimi i inicimit të procedurës për hartimin e “Planit për menaxhimin e Tokave Rurale 2026-2030”	20.03.2026		
Prill	1.Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të punës së Kuvendit për vitin 2026; 2.Shqyrtimi i raportit financiar të Komunës së Junikut për periudhën e parë janar-mars 2026;	30.04.2026	1.Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të punës së Kuvendit për vitin 2026; 2.Shqyrtimi i raportit financiar të Komunës së Junikut për periudhën e parë janar-mars 2026;	21.04.2026		

Maj	3.Nxjerrja e vendimit për fillimin e plotësim-ndryshimeve të projekt Rregullores për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2027;		3.Nxjerrja e vendimit për fillimin e plotësim-ndryshimeve të projekt Rregullores për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2026;			
	4.Nxjerrja e vendimit për fillimin e plotësim-ndryshimeve të projekt Rregullores për taksa komunale për vitin 2027;		4.Nxjerrja e vendimit për fillimin e plotësim-ndryshimeve të projekt Rregullores për taksa, tarifa dhe ngarkesa për vitin 2026;			
	5.Shqyrtimi dhe miratimi i plotësim ndryshimeve të Rregullores për menaxhimin e mbeturinave (leximi i dytë);		5.Shqyrtimi dhe miratimi i plotësim ndryshimeve të Rregullores për menaxhimin e mbeturinave (leximi i dytë);			
	1.Informatë mbi zhvillimin e turizmit në komunën e Junikut;	29.05.2026	1.Informatë mbi zhvillimin e turizmit në komunën e Junikut;	20.05.2026		
Qershor	2.Informatë lidhur me Qarkoren Buxhetore 2027/29 të Ministrisë së Financave;		2.Informatë lidhur me Qarkoren Buxhetore 2027/29 të Ministrisë së Financave;			
	3.Njoftim mbi raportin e performancës për vitin 2024;		3.Njoftim mbi raportin e performancës për vitin 2024;			
	4. Raporti i Planit të Integritetit;		4.Raporti i Planit të Integritetit;			
	Seancë solemne me rastin e Ditës së Çlirimit të komunës së Junikut (13 qershor);	13.06.2026				
	1.Shqyrtimi dhe miratimi i projekt Kornizës Afatmesme	30.06.2026	1.Shqyrtimi dhe miratimi i projekt Kornizës Afatmesme	22.06.2026		

	Buxhetore Komunale 2027-2029; 2.Rishikimi i buxhetit të Komunës së Junikut për vitin 2026; 3. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Punës së KKS-së për vitin 2026; 4.Raportimi i procesit të legalizimit, si dhe vendimi i Ministrisë për zgjatjen e afatit të legalizimit për vitin 2026; 5.Shqyrtimi dhe miratimi i Draft Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal 2026-2033 (leximi i parë);		Buxhetore Komunale 2027-2029; 2.Rishikimi i buxhetit të Komunës së Junikut për vitin 2026; 3.Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Punës së KKS-së për vitin 2026; 4.Raportimi i procesit të legalizimit, si dhe vendimi i Ministrisë për zgjatjen e afatit të legalizimit për vitin 2026; 5.Shqyrtimi dhe miratimi i Draft Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal 2026-2033 (leximi i parë);			
Korrik	1.Shqyrtimi i raportit financiar për periudhën e dytë janar-qershor 2026; 2.Njoftim me raportin e punës së Kryetarit të komunës për 6 mujorin e vitit 2026; 3.Informatë mbi raportin e performancës së administratës së komunës së Junikut për periudhën janar-qershor 2026;	31.07.2026	1.Shqyrtimi i raportit financiar për periudhën e dytë janar-qershor 2026; 2.Njoftim me raportin e punës së Kryetarit të komunës për 6 mujorin e vitit 2026; 3.Informatë mbi raportin e performancës së administratës së komunës së Junikut për periudhën janar-qershor 2026;	22.07.2026		

	4.Shqyrtimi i Raportit dhe analiza suksesit të vitit shkollor 2025/2026; 5.Informatë lidhur me gjendjen e shërbimeve publike në komunën e Junikut janar – qershor 2026; 6.Informatë rreth korrje – shirjeve të grurit në Komunën e Junikut. 7.Shqyrtimi dhe miratimi i Planit zhvillimor të Arsimit në Komunën e Junikut 2026-2030 (Leximi i parë) 8.Shqyrtimi dhe miratimi i Planit tre vjeçar për banim social; 9.Shqyrtimi dhe miratimi i Draft “Planit për menaxhimin e Tokave Rurale 2026-2030” (leximi i parë)		4.Shqyrtimi i Raportit dhe analiza e suksesit të vitit shkollor 2025/2026; 5.Informatë lidhur me gjendjen e shërbimeve publike në komunën e Junikut janar – qershor 2026; 6.Informatë rreth korrje – shirjeve të grurit në Komunën e Junikut. 7. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit zhvillimor të Arsimit në Komunën e Junikut 2026-2030 (Leximi i parë); 8.Shqyrtimi dhe miratimi i Planit tre vjeçar për banim social; 9.Shqyrtimi dhe miratimi i Draft “Planit për menaxhimin e Tokave Rurale 2026-2030” (leximi i parë)			
--	--	--	--	--	--	--

Shtator	1.Dëgjimi publik i Draft Buxhetit Komunal për vitin 2027-2029 2..Shqyrtimin dhe miratimi i Draft Buxhetit për vitin 2027-2029; 3..Shqyrtimi i raportit të auditimit për pasqyrat financiare të Komunës së Junikut për vitin 2025 nga Zyra e Auditorit Kombëtar; 4.Informatë rreth përgatitjeve dhe fillimin e vitit të ri shkollor 2026/2027; 5.Formimi i Grupit të punës për hartimin e projekt Planit të punës së Kuvendit të Komunës së Junikut për vitin 2027;	25.09.2026	1.Dëgjimi publik i Draft Buxhetit Komunal për vitin 2027-2029 2.Shqyrtimin dhe miratimi i Draft Buxhetit për vitin 2027-2029; 3.Shqyrtimi i raportit të auditimit për pasqyrat financiare të Komunës së Junikut për vitin 2025 nga Zyra e Auditorit Kombëtar; 4.Informatë rreth përgatitjeve dhe fillimin e vitit të ri shkollor 2026/2027; 5.Formimi i Grupit të punës për hartimin e projekt Planit të punës së Kuvendit të Komunës së Junikut për vitin 2027;	16.09.2026		
----------------	---	-------------------	---	-------------------	--	--

Tetor	1.Shqyrtimi i Raportit financiar të Komunës së Junikut për periudhën e tretë janar-shtator 2026; 2.Informatë mbi gjendjen e shëndetit publik në komunën e Junikut; 3.Shqyrtimi dhe miratimi i Projekt Rregullores për Taksa komunale për vitin 2027; 4.Shqyrtimi dhe miratimi i Projekt Rregullores për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2027; 5.Shqyrtimi dhe miratimi i Planit zhvillimor të Arsimit në Komunën e Junikut 2026-2030 (Leximi i dytë) 6.Shqyrtimi dhe miratimi i Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal 2026-2033;	30.10.2026	1.Shqyrtimi i Raportit financiar të Komunës së Junikut për periudhën janar -shtator 2026; 2.Informatë mbi gjendjen e shëndetit publik në komunën e Junikut; 3.Shqyrtimi dhe miratimi i Projekt Rregullores për Taksa, Ngarkesa dhe Gjoha Komunale për vitin 2027; 4.Shqyrtimi dhe miratimi i Projekt Rregullores për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2027; 5.Shqyrtimi dhe miratimi i Planit zhvillimor të Arsimit në Komunën e Junikut 2026-2030 (Leximi i dytë) 6.Shqyrtimi dhe miratimi i Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal 2026-2033;	21.10.2026		
-------	--	------------	---	------------	--	--

Nëntor	1.Shqyrtimi dhe miratimi i Planit vjetor të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2027; 2.Informatë lidhur me zbatimin e rregulloreve komunale dhe dokumenteve strategjike komunale. 3.Shqyrtimi dhe miratimi i "Planit për menaxhimin e Tokave Rurale 2026-2030"	30.11.2026	1.Shqyrtimi dhe miratimi i Planit vjetor të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2027; 2.Informatë lidhur me zbatimin e rregulloreve komunale dhe dokumenteve strategjike komunale. 3.Shqyrtimi dhe miratimi i "Planit për menaxhimin e Tokave Rurale 2026-2030".	20.11.2026		
Dhjetor	1.Njoftimi me Planin vjetor të punës së Zyrës së Prokurimit; 2. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Punës së KKSB-së për vitin 2027;	30.12.2026	1.Njoftimi me Planin vjetor të punës së Zyres së Prokurimit ; 2. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Punës së KKSB-së për vitin 2027;	22.12.2026		

Sqarim:

Grupi punues për hartimin e Planit vjetor për punën e Kuvendit Komunal me kujdes dhe përgjegjësi ka shqyrtuar të gjitha ligjet dhe aktet tjera nënligjore të nivelit qendror e të cilat kanë të bëjnë me përgjegjësitë dhe kompetencat ligjore të Kuvendit Komunal dhe kryetarit të Komunës dhe me përpikëri dhe përkushtim më të madh i ka përfshirë në këtë plan si aktivitete me qëllim që Kuvendi të jetë sa më funksional dhe përgjegjës në realizimin e kërkesave të qytetarëve, anëtarëve të Kuvendit, KPF-së, KK-së, dhe të kërkesave dhe përgjegjësi të kryetarit të Komunës. Mirëpo, sigurisht që dinamika e këtij plani gjatë zbatimit mund të pësoj ndryshime dhe plotësime sipas nevojës dhe paraqitjes së kërkesave të arsyeshme qoftë nga ana e qytetarëve, delegatëve të Kuvendit dhe kryetarit të Komunës apo edhe përgjegjësi të tjera që dalin nga miratimi i ligjeve të reja dhe aktiviteteve tjera nënligjore.

Anëtarët e Komisionit për hartimin e Planit të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2026:

1. **Leonard Llojuni**, Kryesues- Kryesues i Kuvendit Komunal;
2. **Aldi Gacaferi**, anëtar i Kuvendit nga AAK;
3. **Floris Miroci**, anëtar i Kuvendit nga LDK;
4. **Elsa Hima**, anëtare e Kuvendit nga LVV;
5. **Leonora Shehu**, anëtare- Drejtoreshë e Administratës

Afatei për përmbushjen dhe realizimin e aktiviteteve të parapara:

- Realizimi i aktiviteteve të parapara me planin e punës së Kuvendit të Komunës së Junikut do të bëhet brenda dymbëdhjetë muajve të vitit 2026.

Kryesues i Kuvendit të Komunës së Junikut


z. Leonard Llojuni

